



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2024:034708

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05679607

C.nr.703/23

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. D, nga fshati - Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson i autorizuari Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës: Komuna e Klinës-D ne Klinë, me bazë juridike: kompensim i shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit, vlera e kontestit: 783.95€, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. D, nga fshati Komuna Klinë dhe DETYROHET e paditura Komuna Klinës-D, që paditësit F. D, në emër të kompensimit të shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 773.86€, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 27.11.2023 (data e paraqitjes se padisë) të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Klinës-D që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për detyrimin e të paditurës që në emër të kompensimit të shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit për periudhën kohore Janar-Nëntor 2020 t'ia paguaj shumën prej 10.01€ e PABAZUAR

### A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë me datë 27.11.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Klinës-D, me bazë juridike kompensim i shtesës në pagë në emër të rritjes së inflacionit bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, përkatësisht kapitullit IV që ka të bëjë me rregullat për pagat, nenit 35 par.10 sipas të cilit “për çdo vit të përcjellët shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësit. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim-pagesën e përqindjes në emër të inflacionit, paditësi përmes të autorizuarit të saj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shtesën në pagë në emër të inflacionit si vijon: për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2020 për  $0.2\% \times 459 = 0.91 \times 12$  muaj = 11.10 Euro, për periudhën Janar-Dhjetor 2021 për  $3.4\% \times 459 = 15.60 \times 12 = 187.27$  dhe për periudhën Janar-Nëntor 2022 për  $11.6\% \times 459 = 53.24 \times 11 = 585.68$  Euro , në total 783.95 Euro me kamate ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore.

E paditura Komuna e Klinës-D, përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 12.04.2024, ku ka theksuar se kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, për shkak të mos ekzistimit të bazës juridike dhe ligjore si dhe vlerës së lartcekur. E paditura ka theksuar se as Komuna e Klinës as DKA-ja në Klinë, nuk janë nënshkruese të kontratës së tillë kolektive të lëmisë së arsimit madje punëdhënësi Komuna e Klinës dhe DKA-ja e saj nuk e kanë të nënshkruar as Kontratën Kolektive adekuate të nivelit lokal siç e parasheh dispozita e nenit 90 par 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit të punës, pra Komuna e Klinës si dhe DKA-ja, përmes Organizatës sindikale të arsimit nuk e kanë të lidhur dhe nënshkruar një kontratë të tillë në nivel ndërmarrjeje apo si punëdhënësi, krejt kjo do të thotë se në rastin konkret DKA-ja e Komunës së Klinës, në cilësinë e punëdhënësit në njërin anë dhe Organizata Sindikale komuna e arsimit, në anën tjetër nuk kanë të lidhur kontratë të tillë kolektive në kuadër të ndërmarrjes-lëmisë së arsimit, prandaj e paditura nuk mund të merr përsipër kurrfarë detyrimesh të tilla të pa kontraktuara si këto pretenduese të paditësve. po ashtu i autorizuari i të paditurës ka theksuar se Komunës së Klinës dhe DKA-së, në kuadër të saj në veçanti i mungon legjitimacioni pasiv, në

këtë rast konkret kontestimor juridiko-civil. Ka theksuar më tej se, kërkesa e paditësit është e parashkruar. Tutje, thekson se padia është e jashtëafatshme, bazuar në nenin 87 të Ligjit të punës, si dhe kanë kaluar mbi 5 vite, nga nënshkrimi i Kontratës Kolektive, të vitit 2017 dhe kërkesat janë parashkruar tërësisht, si dhe e paditura pa fajin e saj nuk ka mjete financiare e as mundësi buxhetore për pagesat e tilla pasi Ministria e Financave nuk ka krijuar linjë të veçantë buxhetore për kompensimin e kërkesave lëndore.. Andaj ka kërkuar që padia dhe kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse, të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nuk janë kontestuese faktet si në vijim:

Paditësi, është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHMP “Fehmi Agani” në Klinë, si mësimdhënës i lëndëve profesionale dhe paga bazë e tij është në lartësi prej 459.00€, fakte të vërtetuar përmes Kontratave të punës të lëshuara nga e paditura dhe lista e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020, ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa

*të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë(KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës, sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, si në vijim:

Për periudhën Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 0.2%, apo 0.91€ (459.00paga bazë  $\times 0.2\% = 0.91 \times 1$  muaj 0.91).

Për periudhën Janar-Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 3.4% apo 187.20€ (459€ paga bazë  $\times 3.4\% = 15.60 \times 12$  muaj =187.27€).

Për periudhën Janar-Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla mesatare e inflacionit ka qenë 11.6% apo 585.64€ (459€ paga bazë  $\times 11.6\% = 53.24 \times 11$  muaj =585.68€).

E paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit që t’ia kompensoj pagesën shtesë në emër të rritjes së inflacionit, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Sipas nenit 245 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parashihet se *“kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Duke qenë se mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, përkatësisht se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe se në periudhën kohore nga data 01.12.2020 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësit nuk i është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së.

E paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit sipas nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, nga rrjedh se kërkesat monetare e të punëmarrësit parashkruhen në i/e njëjti/a nuk ka kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e tyre brenda afatit prej tri vjetësh.

Gjykata në kuptim të nenit 341 paragrafi 3 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve me të cilën parashihet se “Gjykata nuk mund të merr parasysht parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”, vlerësoi prapësimin e ngritur nga e paditura lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit.

Duke qenë se paditësi ka ushtruar padi në Gjykatë me 27.11.2023, atëherë Gjykata gjen se të gjitha kërkesat që datojnë nga muaji Janar-Nëntor 2020 janë parashkruar, pasi që padia është parashtruar pas kalimit të afatit prej tri vitesh nga dita e arritjes së tyre. Andaj gjykata vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo ky pretendim ishte i pabazuar për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe se i mungon legjitimiteti real pasiv, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëseve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësit.

Pretendimin tjetër të të paditurës, lidhur me atë se Ministria e Financave, nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore, gjykata e konsideron si të parëndësishëm, për arsye se çështja e pagës së punëtorëve është e rregulluar me KKAK, andaj është irelevante se a prishet skema buxhetore e Komunës, për aq kohë sa e drejta e paditëseve për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 452.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ashtu që paditësit ti pranohen shpenzimet në shumën e përgjithshme prej 124.00€, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00€, për taksën gjyqësore për padi, shumën prej 20.00 euro.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

C.nr.703/23 i dt. 13.05.2024

Gj y q t a r ja,  
Fllanza Hashani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.